



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/19


Datë: 18.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 18 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për rregullimin e Fushës së Mjekësisë Ligjore.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

**KONCEPT DOKUMENT PËR RREGULLIMIN E FUSHËS SË
MJEKËSISË LIGJORE**

Kapitulli 1: Hyrje

Rregullimi i fushës së Mjekësisë Ligjore deri me tani ka qene i rregulluar përmes dy ligjeve; Ligji për Themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore - ligji me nr 2009/03-L-137, ka hyrë në fuqi me 17.07.2009, dhe Ligji për Mjekësi Ligjore-ligji me nr 2010/03-L-187, ka hyrë në fuqi me 13.05.2010

Shërbimet Mjeko-Ligjore në territorin e Kosovës për herë të parë në menyrë të organizuar kanë filluar të ofrohen në vitin 1963, në kuadër të Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës (Shërbimit të Anatomisë dhe Patologjisë).

Në vitet e hershme të 70-tave, me rastin e krijimit të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës, ky shërbim është transformuar në Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Në vitin 2002, është krijuar Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore në kuadër të ish-Departamentit të Drejtësisë-UNMIK, e cila ka funksionuar paralel me Institutin e Mjekësisë Ligjore deri në vitin 2009. Në vitin 2009, është themeluar Departamenti i Mjekësisë Ligjore, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë duke unifikuar (fusionuar) ish-Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe ish-Zyrën për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore.

Meqë kanë qenë dy institucione që janë marrë gati në menyrë paralele me shërbimet mjeko ligjore në Kosovën e pasluftës; **Instituti i Mjekësisë Ligjore** (i cili funksiononte në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë) dhe **Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore** (i cili fillimisht ishte në kuadër të UNMIK-ut e me vonë me rastin e krijimit të Ministrisë së Drejtësisë është bartur si kompetencë e rezervuar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë), është parë e nevojshme atëherë që të bëhet fusionimi i këtyre dy institucioneve dhe krijimi i një institucioni të vetëm në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, përmes një ligji (Ligji për Themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore).

Rregullimi i kësaj fushe ndërlihet me:

Planin zhvillimor strategjik 2012 – 2016 të Ministrisë së Drejtësisë, i cili ndër të tjera rregullon edhe fushën e mjekësisë ligjore, ku në njerën nga objektivat e tij- *“Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve të mjekësisë ligjore, gjetja dhe identifikimi i personave të zhdukur gjatë luftës dhe hulumtimi i krimeve të luftës”* ka paraparë ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe ristrukturimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore (DML). Pra, që nga viti 2012-2016 me këtë dokument është paraparë ngritja e kapaciteteve të këtij departamenti ndërsa në vitin 2015 rishikimi i statusit të ardhshëm të DML-së.

Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë në Planin Vjetor të punës së Qeverisë (PVPQ), përmes objektivës së katër të këtij plani (objektiva e lartcekur) janë të përcaktuara edhe dy aktivitete si: Fuqizimi i Departamentit të Mjekësisë Ligjore; Intensifikimi i përpjekjeve për zbardhjen e fatit të zhdukurve. Kjo çështje është paraparë edhe në Marrëveshjen e Kompaktit midis Qeverisë dhe EULEX-it, në Konkluzionet e Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit për drejtësi, liri dhe siguri i mbajtur më 27-29 janar 2015 në Bruksel.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Ligji aktual Nr. 03/L-187 për Mjekësinë Ligjore neni 4, paragrafi 1 përcakton "Autopsia mjekoligjore kryhet vetëm në bazë të urdhrit të lëshuar nga gjykata kompetente" ka kolizion dhe duhet të harmonizohet me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht Neni 137 i cili përcakton "Para angazhimit të ekspertit, prokurori i shtetit nxjerr vendim në të cilin..". Andaj kolizioni në mes të këtyre dispozitave ekziston rreth çështjes së angazhimit të ekspertit (duke përfshirë edhe ekspertin mjeko - ligjor), e që sipas Ligjit për Mjekësinë Ligjore, ekspertimi mjeko - ligjor bëhet vetëm në bazë të urdhërit të lëshuar nga gjykata, kurse sipas Kodit të Procedurës Penale angazhimi i ekspertit (duke përfshirë në këtë rast edhe ekspertin mjeko - ligjor) bëhet në bazë të vendimit të prokurorit të shtetit.

Legjislacioni i cili rregullon fushën e mjekësisë ligjore duhet të harmonizohet me Ligjin Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Republikën e Kosovës si dhe harmonizimi i legjislacionit të ri me dispozitat përkatëse të këtij ligji sa i përket mandatin të EULEX-it, që i referohet dispozitave të nenit 8 të Ligji për Departamentin e Mjekësisë Ligjore, sipas Ligjit aktual (Neni 8 (3.1)) përfaqësuesi i EULEX-it është bashkëdrejtues i Departamentit të Mjekësisë Ligjore, andaj kjo çështje duhet të ndryshohet pasiqë aktualisht DML-në e udhëheq vetëm Drejtori i DML-së, që është vendor. Kjo çështje është rregulluar në këtë mënyrë edhe në Ligjin Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Republikën e Kosovës.

Poashtu, kjo çështje është prioritet dhe synim i Ministrit të Drejtësisë, që Departamenti i Mjekësisë Ligjore të avancohet në nivel të agjencisë, i cili parashihet të funksionoj si organ qendrorë i administratës shtetërore në varësi të Ministrit të Drejtësisë.

Çështje tjetër është avancimi i departamentit të mjekësisë ligjore në organ qendror të administratës shtetërore me rishtruktivimin e paraparë sipas ligjit për administratë shtetërore dhe rregullimi i statusit të nënpunësve të departamentit të mjekësisë ligjore.

Nga shërbimet e ofruara mjeko ligjore të cilat i ofron Departamenti i Mjekësisë Ligjore përfitojnë Institucionet Publike si Gjykatat, Prokuroritë, Policia dhe organet tjera.

Mjekësia ligjore ofron shërbime mjeko ligjore në mënyrë të pavarur dhe profesionale me urdhër të organeve gjyqësore. Gjithashtu, përmes procesit të edukimit dhe avansimit të gjeneratave të reja me ofrimin e njohurive nga mjekësia ligjore për studentet e mjekësisë, drejtësisë etj.

Numri i institucioneve që preken nga ky problem:

Numri i institucioneve që atakohen (preken) nga ky problem janë shumë institucione në tërë vendin tonë, si Prokuroria e Shtetit, Gjykatat dhe Policia e Kosovës fakultetet i mjekësisë, drejtësisë etj.

Informata shtese

Edhe pse në zbatimin e dispozitave ligjore përkatëse në të mjekësisë ligjore, gjatë ekzaminimit, janë marrë parasysh standardet ekzistuese, me ligjin e ri do të formalizohen dhe do të jenë obligative duke u zbatuar përshtatshëm krahas dispozitave ligjore vendore. Përmes kësaj ndihmojn gjykatatë për të vendosur çështjen gjyqësore. Vlen të theksohet se lidhur me harmonizimin e dispozitave të fushës së mjekësisë ligjore me standardet ndërkombëtare, Ministria me rastin e hartimit të akteve nënligjore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale janë marrë parasysh standardet ekzistuese ndërkombëtare të cilat janë përfshirë në aktet nënligjore (Rekomandimi Nr.(99) 3 të Këshillit të Evropës të Komitetit të Ministrave).

Politika aktuale

Fusha e mjekësisë ligjore aktualisht është rregulluar me Ligjin nr. 03/I-187 për Mjekësinë Ligjore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: nr. 70/31 Maj 2010) dhe Ligjin nr. 03/I-137 për Departamentin e Mjekësisë Ligjore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: nr. 58/10 Gusht 2009). Përgjegjëse për zbatimin e këtyre ligjeve është Departamenti i Mjekësisë Ligjore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Sipas legjislacionit aktual Departamenti i Mjekësisë Ligjore (DML) është përgjegjës për ofrimin e ekzaminimeve mjeko ligjore për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Departamenti i Mjekësisë Ligjore është themeluar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë në bazë të Ligjit Nr.03/L-137 dhe fushëveprimi i Departamentit të Mjekësisë Ligjore është rregulluar me Ligjin për mjekësinë ligjore Nr. 03/L-187.

Departamenti i Mjekësisë Ligjore kryen këto detyra: mbajtjen e të drejtës për të siguruar ekspertizë mjekoligjore për organet publike, për të udhëhequr hetimet mjekësore për vdekjen në vendin e ngjarjes, për të kryer ekshumime (zhvarrosje), për të kryer inspektime post-mortem (pas vdekjes) dhe autopsi, ekzaminimin e viktimave që kanë pësuar nga veprat penale kundër jetës dhe trupit, përcaktimin e seksit (gjinisë), racës, gjatësisë, moshës, dhe shkakun e vdekjes të mbetjeve mortore të një personi të pa identifikuar kurdoherë që është e mundur, kryerjen e autopsisë dhe/ose profilit antropologjiko biologjik dhe lëshon raport të autopsisë në raste të zbulimit të mbetjeve mortore, mbajtjen e të drejtës ekskluzive për koordinimin dhe udhëheqjen e ekzaminimeve klinike për viktimat, dëshmitar dhe autorët e mundshëm (supozuar) të krimit kundër integritetit seksual, kërkimin e dokumenteve mjekësore që kanë të bëjnë me viktimën dhe/ose të pandehurin për krimet kundër jetës dhe trupit, mbledhje ose ekzaminon dëshmitë e gjetura nga viktimat, dëshmitarët, apo të pandehurit e krimeve kundër integritetit seksual dhe veprave penale kundër jetës dhe trupit, bazuar në Kodin Penal të Kosovës.

Ligjet dhe aktet nënligjore

- Ligjin nr. 03/L-187 Për Mjekësinë Ligjore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: nr. 70 / 31 Maj 2010);
- Ligjin nr. 03/L-137 për Departamentin e Mjekësisë Ligjore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: nr. 58 / 10 Gusht 2009);
- Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale
- Ligjin, Ligji Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Republikën e Kosovës, Udhëzim Administrativ QKR-nr. 07/2013 për kompensimin e punës jashtë orarit dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të ekspertëve mjeko - ligjor.
- Rregullorja për fushat e përgjegjësis Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (SHTOJCA 1).

Shpenzimet aktuale

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike në vitin paraprak 2014	Buxheti këtë vit 2015	KASH për vitin e ardhshëm 2016
Buxheti i Departamentit për Mjekësi Ligjore:	692.50 €	805.00 €	705.00€
-Paga dhe mëditje	463.00€	433.00€ 230.00€	433.00€ 230.00€

-Mallra e shërbime	189.50€	42.00	42.00€
-Shpenzime Komunale	40.00€	100.00€	0.00€
-shpenzime Kapitale (shëno secilin lloj të shpenzimit)	00.00€		
Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit)			
Financimi nga donatorët			
-Grandi Belg 89	113.00 €	61.00€	
-Grandi Zvicrran 61			
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave			

Përvoja në shtetet tjera

Shtetet e rajonit dhe me gjerë fusheveprimin e mjekësisë ligjore e kanë të rregulluar përmes ligjeve të veçanta dhe rregulloreve. Në shumë nga ato organizimi i sistemeve mjeko-ligjore dallon. Në disa nga romandimet e tij Këshilli Evropian ka sugjeruar përafrimin e legjislacionit në këtë fushë për vendet evropiane p.sh me Rekomandimin Nr.(99) 3 të Keshillit të Evropës të Komitetit të Ministrave).

Shumica nga ato e kanë të organizuar si shërbim mjeko ligjor qendror dhe deget e saj, në disa vende shërbimet e mjekësisë ligjore janë nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë (Shqipëria), në disa nën Ministrinë e Arsimit (Kroacia), në disa nën Ministrinë e Puneve të Brendshme, e në disa të tjera nën Ministrinë e Arsimit. Në disa vende janë fusiuar të gjitha shërbimet mjeko ligjore (mjekësia ligjore, toksikologjia mjeko ligjore, histopatologjia mjeko ligjore, biologjia mjeko ligjore, kriminalistika dhe balistika mjeko ligjore, psikiatria mjeko ligjore etj.) nën një institucion qendror me departamente të veçanta të quajtura si Institut i Shkencave Mjeko Ligjore (Portugali).

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Synimi

Avancimi i fushës së Mjekësisë Ligjore në Kosovë, me qëllim të harmonizimit me Kodin e Procedurës Penale, me ligjet tjera që prekun këtë fushë në vendin tonë, dhe me rekomandimet e Keshillit Evropian për mjekësi ligjore.

Objektivat

- Përmiresimi i Kornizes Ligjore për mjekësinë ligjore;
- Arritja e standardeve mjeko-ligjore të njohura ndërkombëtare;

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)

Aktualisht fusha e mjekësisë ligjore është e mbuluar me Ligjin nr. 03/L-187 Për Mjekësinë Ligjore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: nr. 70 / 31 Maj 2010); si dhe Ligjin nr. 03/L-137 Për Departamentin e Mjekësisë Ligjore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: nr. 58 / 10 Gusht 2009);

Mosndryshimi i zbatimit të politikës aktuale përkatësisht legjislacionit aktual, do të pamundësonte zbatimin në praktikë në mënyrë efikase në kryerjen e ekzaminimeve mjeko ligjore si dhe do të vazhdohej me pengesat ekzistuese lidhur me këtë çështje ku Ligji aktual nr. 03/L-187 për Mjekësinë Ligjore (neni 4) ka kolizion dhe duhet të harmonizohet me dispozitat e Kodit të Procedures Penale, përkatësisht Neni 137 i Kodit me Ligjin për Mjekësinë Ligjore.

Legjislacioni i cili rregullon fushën e mjekësisë ligjore duhet të harmonizohet me Ligjin Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Republikën e Kosovës si dhe harmonizimi i legjislacionit të ri me dispozitat përkatëse të këtij ligji sa i përket mandatit të EULEX-it, që i referohet dispozitave të nenit 8 të Ligji për Departamentin e Mjekësisë Ligjore.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Politika ekzistuese mund të ndryshohet me miratimin e Ligjit të ri që do të rregullonte fushën e Mjekësisë Ligjore, si dhe ndryshimi dhe ristrukturimi i Departamentit aktual të Mjekësisë Ligjore.

Ligji i ri do të rregullonte procedurat për kryerjen e ekzaminimeve mjeko-ligjore, themelimin, veprimtarinë dhe strukturën e Agjencisë për Mjekësinë Ligjore, si organ qendror i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, e cila do ta ketë statusin e personit juridik.

Për zbatimin e Ligjit të ri do të jenë kompetente Agjencia për Mjekësi Ligjore, e cila do të jetë përgjegjëse për kryerjen e veprimtarive si në vijim:

- ekzaminimin mjeko ligjore lidhur me autopsinë mjeko-ligjore, ekzaminimin klinik mjeko-ligjor, ekzaminimin e provave materiale biologjike, si dhe ekzaminimet tjera mjeko-ligjore të parapara me ligj, sipas vendimit të Gjykatës apo Prokurori i Shtetit

- mbajtjen e regjistrave të të gjitha rezultateve mjeko ligjore në bazë të urdhrit të gjykatës apo prokurori shtetit;
- kujdeset për ruajtjen e rezultateve të ekzaminimit molekular dhe gjenetik në pajtim me dispozitat ligjore;
- kërkimin, marrjen, sigurimin dhe verifikimin e informacioneve lidhur me vendndodhjen dhe fatin e personave të zhdukur dhe kthimin e eshtrave të personave të zhdukur, shfrytëzimin e ndihmës dhe të ekspertizës së personelit përkatës, si dhe të specialistëve të tjerë, në pajtim me dispozitat në fuqi;
- kryen veprimtari arsimore dhe shkencore hulumtuese në pajtim me ligjin;

Ligji i ri do të ketë funksionin e kryerjes së ekzaminimeve mjeko ligjore si dhe karakter rregullativ dhe në të nuk do të jenë të paraparë sanksione apo dënime tjera të aplikueshme.

Sa i përket koston financiare e cila parashihet në draftin e koncept dokumentit parashihet një kosto minimale shtesë e cila dedikohet kryesisht në paga sa i përket rritjes së koeficienteve të stafit udhëheqës, si dhe nuk parashihet të ketë staf shtesë. Për me tepër, sipas planifikimeve në nivel të Ministrisë së Drejtësisë, është parapare që pas miratimit eventual të draftit të këtij koncept dokumenti, sipas këtij opsioni të rekomanduar, momenti i hyrjes në fuqi të Ligjit që do ta avanconte Departamentin aktual të Mjekësisë Ligjore në Agjenci, do të jetë së paku fillimi i vitit 2016, dhe me këtë rast Ministria e Drejtësisë do të ndërmarrë veprimet e duhura që kjo kosto shtesë të përfshihet në projeksionet buxhetore në të ardhmen, dhe atë me rastin e ndryshimit eventual të kornizës së shpenzimeve si dhe në buxhetin e vitit 2016.

Ministria e Drejtësisë vlerëson se do ketë nevojë për trajnime për stafin e Agjencisë për Mjekësisë Ligjore si Agjenci përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji. Për organizimin e këtyre trajnimeve janë të parapara mjetet buxhetore, ku pjesa dërmuese do të mbulohen nga projekti i IPA-së "Fuqizimi dhe Modernizimi i Shërbimeve të Mjekësisë Ligjore në Kosovë" i financuar nga Komisioni Evropian, përmes të cilit në periudhën dy vjeçare janë paraparë edhe trajnimet.

Trajnimet për stafin do të fokusohen në dy drejtime dhe atë në aspektin profesional me qëllim të ngritjes dhe avancimit të stafit sa i përket ofrimit të shërbimeve mjeko ligjore sa me efikase, si dhe për stafin udhëheqës më qëllim të ngritjes dhe avancimit të stafit udhëheqës dhe menaxhimit në mënyrë sa më efikase Agjencinë.

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistues të zbatimit

Ndryshimi dhe plotësimi i ligjeve aktuale me të cilat është rregulluar fusha e mjekësisë Ligjore (Ligjin nr. 03/L-187 Për Mjekësinë Ligjore dhe Ligjin nr. 03/L-137 Për Departamentin e Mjekësisë Ligjore) nuk do të garantoj se do arriheshin objektivat perkitazi me ofrimin e shërbimeve mjeko ligjore në Kosovë, për shkak të kolizionit dhe

synimeve të Ministrisë së Drejtësisë në drejtim të ngritjes së kapaciteteve dhe ngritjen e Departamentit aktual të Mjekësisë Ligjore në nivel të Agjencisë.

Mënyra tjera të zbatimit në rast të qëndrimit të ligjit aktual, do të jenë vështirë të aplikueshme, pasi që ligji aktual nuk është koherent dhe si i tillë ka kolozion me ndryshimet që janë bërë në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale siç është cekur më lartë (tek definimi i problemit)

Në rast të ndryshimit të mënyrës së zbatimit, përgjegjësia do të jetë përsëri e Departamentit të Mjekësisë Ligjore pasi që kjo përgjegjësi është shprehimisht e rregulluar me ligjin aktual.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Status Quo	Ligji i ri	Ndryshimi dhe plotësimi i ligjeve aktuale
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar	Republika e Kosovës	Republika e Kosovës	Republika e Kosovës
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	Departamenti për Mjekësi Ligjore.	Agjencia për Mjekësi Ligjore, si organ ekzekutiv nën varësi të Ministrisë së Drejtësisë	Departamenti për Mjekësi Ligjore
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	Nuk është paraparë	Nuk është paraparë	Nuk është paraparë
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve	Ligji për Mjekësinë Ligjore dhe Ligji për Departamentin e	Ligji për Mjekësinë	Ligji për Mjekësinë Ligjore dhe Ligji

ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Mjekësisë Ligjore	Ligjore	për Departamentin e Mjekësisë Ligjore
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat	Nuk ka ndryshim	Nuk ka stimulime ose subvencione	Nuk ka ndryshim
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	Nuk ka ndryshim	Nuk janë paraparë	Nuk ka ndryshim
Udhëzimet dhe kodet	Nuk është paraparë	Nuk është paraparë	Nuk është paraparë
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni	është në fuqi	2015	2015

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Përfitimet

Opsioni 1 (status quo).

Perfitimet aktuale sipas opcionit të parë duhet të avancohen ngase si të tilla janë të pamjaftueshme.

Opsioni 2. Ndryshimi i politikës ekzistuese.

Në rastin e opsionit 2 (ndryshimi i politikës ekzistuese), do të miratohej Ligji i ri që do të rregullonte dhe avancohe fushën e Mjekësisë Ligjore. Përfitim i drejtpërdrejtë do të jetë zbatimi i suksesshëm në ofrimin në mënyrë efikase dhe efektive të ekzaminimeve mjeko-ligjore si dhe marrjen e përgjegjësive shtesë nga autoritetet e EULEX-it sa i perket fushës mjeko-ligjore.

Opsioni 3 Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Siç është cekur më lartë tek opsioni 3 parasheh ndryshimin e ligjeve ekzistuese. Ky opsion në praktikë është i mundshëm, por zbatimi i tij do të jetë i vështirë dhe nuk do të arrihen efektet e duhura dhe të pritshme.

Pasojat negative

Zbatimi i opsionit 1 (status quo), gjegjësisht mbetja në fuqi e ligjeve ekzistuese, do të ketë pasoja negative ngase nuk e garanton efikasitetin e duhur për shkak të kolizionit ligjor si dhe e pamundëson avancimin e Departamentit aktual të Mjekësisë Ligjore.

Të opsioni i dytë nuk janë vërejtur pasoja negative por megjithatë ndryshimi dhe avancimi i Departamentit në nivel të Agjencisë do të ketë ndryshime organizative.

Pasojat negative të opsionit 3 janë vështirësitë e implementimit të mënyrave të tjera të zbatimit të legjislacionit ekzistues që rregullon këtë fushë.

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar

	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4
Opsioni 1				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0.00	0.00	0.00	0.00
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët	30.00			
Opsioni 2				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	35.1	35.10	35.10	35.10
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët	30.00			
Opsioni 3				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	180.10	180.10	180.10	180.10
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët				

Kapitulli 7: Konsultimi

Konsultimi me ekspertë

Ky koncept dokument është hartuar nga grupi punues ku në përberje të tij kanë marrë pjesë ekspertet e fushës së mjekesise ligjore të cilet njëherit kanë ofruar edhe sqarimet e nevojshme për problemet e zbatimit të ligjit aktual, pengesat për ofrimin e shërbimeve mjekoligjore. Poashtu, në këtë në draftimin e këtij koncept dokumenti kanë marrë pjesë zyrtare nga Departamenti Ligjor, Departamenti për Integrim Evropian dhe koordinim të politikave, dhe nga divizioni i buxhetit dhe financave në konsultim me zyrtaret përkatës të Ministrisë së Financave. Gjatë kësaj faze meqë kjo fushë prek direkt punën e Departamentit të Mjekësisë ligjore dhe konsultimi me ministrinë dhe institucionet tjera është bërë në bazë të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. nr. 09/2011 neni 7.

Institucionet të cilat janë konsultuar për këtë koncept dokument janë :

Agjencia për Barazi Gjinore, Zëdhënësi i Qeverisë/Zyra për Komunikim Publik, Sekretariati Koordinues i Qeverisë - ZKM, Zyra për Planifikim Strategjik-ZKM, Zyra Ligjore- ZKM, Zyra për Qeverisje të Mirë-ZKM, Ministria për Financa, Ministria për Integritet Evropian, Ministria për Administratë Publike, Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Sekretariati i Këshillit Konsultativ Për Komunitete, Avokati i Popullit, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, OJQ, OSBE, EULEX Zyra Ligjore, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës. Nga të gjitha këto institucione përveç Sekretariatit Koordinues të Qeverisë nuk kemi pranuar asnjë koment.

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1 - status quo, kjo fushë do të vazhdonte të ballafaqohej me vështërsi dhe jo efikasitet për shkak të legjislacionit në fuqi.

Opsioni 2 - miratimi i Ligjit të ri do të rregullonte fushën e mjekësisë ligjore në mënyrën më adekuate duke shmangur pengesat, vështësitë në zbatimin e legjislacionit aktual.

Opsioni 3 apo ndryshimi i zbatimit është i pamundur të aplikohet në praktikë, meqenëse ashtu siç është cekur më lartë, rregullativa e Ligjit aktual nuk është në pajtim me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në këtë fushë.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Pas analizave të bëra, Ministria e Drejtësisë propozon miratimin e koncept dokumentit me propozim për miratimin e opcionit nr 2, hartimin e Ligjit të ri gjatë vitit 2015, (me kosto siç është e përcaktuar në tabelën e lartëcekur), i cili do të rregullonte zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e legjislacionit aktual, në relacion me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, është opsioni adekuat për arritjen e këtyre synimeve dhe objektivave dhe njeherit është domosdoshmëri harmonizimi i Ligjit të ri me Kodin.

Kapitulli 10: Komunikimi

Ministria e Drejtësisë do të jetë e përqendruar në ofrimin e informacioneve lidhur me detajet e procesit të hartimit të Projektligjit, ku do të merren parasysh konsultimet me ekspertët nga lëmi i caktuar, si dhe konsultimi me shoqërinë civile dhe me akerët tjerë relevant.

Format e komunikimit do të jenë të ndryshme, duke filluar nga takimet, grupet punuese dhe publikimet në ueb faqen e Ministrisë.